

## KOSOVA

### RAPORTI I VITIT 2020 PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

#### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**NJOFTIM:** Departamenti i Shtetit do ta lëshojë një shtesë për këtë raport nga mesi i vitit 2021 që e zgjeron nënseksionin për Gratë në Seksionin 6 për ta përfshirë një gamë më të gjerë të çështjeve lidhur me të drejtat riprodhuese.

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë një parlament të zgjedhur njëdhomësh (Kuvendin), i cili më pas zgjedh një kryetar. Kuvendi duhet ta miratojë kryeministrin të cilin e zgjedh kryetari. Zgjedhjet parlamentare u mbajtën për herë të fundit në tetor 2019 në një proces që konsiderohej në përgjithësi i drejtë dhe i lirë, megjithëse vëzhguesit e zgjedhjeve të Bashkimit Evropian theksuan se keqpërdorimi i burimeve publike dhe mungesa e transparencës së financave të fushatës rezultuan në një fushatë të pabarabartë në të gjithë vendin. Kuvendi u themelua në dhjetor 2019. Albin Kurti u konfirmua si kryeministër në shkurt. Pasi një votim i mosbesimit e rrëzoi qeverinë e Kurtit në mars, Avdullah Hoti u zgjodh kryeministër më 3 qershor në një qeveri të rithemeluar.

Forcat e sigurisë përfshinin Policinë e Kosovës (PK) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilat i raportojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, respektivisht Ministrisë së Mbrojtjes. Qeveria vazhdoi procesin e transformimit gradual të FSK-së në një forcë mbrojtëse territoriale, sipas një plani 10-vjeçar që filloi në vitin 2019. Policia Kufitare, një nëngrup i PK-së, është përgjegjëse për sigurinë në kufi. Policia ruan sigurinë e brendshme me ndihmën e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, në vend, si reagues i dytë për incidente trazirash. Forca e Kosovës (KFOR) e udhëhequr nga NATO-ja, një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare, është reaguese e tretë. KFOR-i është përgjegjës për sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt dhe për sigurimin e lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët. Që nga gushti, KFOR-i kishte rreth 3.400 ushtarë nga 27 vende. Autoritetet civile mbajtën kontroll efikas të forcave të sigurisë. Anëtarë të forcave të sigurisë kryen disa abuzime, përfshirë përdorimin e tepërt të forcës dhe keqtrajtimin e të burgosurve nga policia.

Në çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshiheshin: kufizimet e panevojshme ndaj shtypit, përfshirë dhunën ose kërcënimet e dhunës ndaj gazetarëve; korrupsionin në qeveri dhe mosndëshkimin; dhe sulmet kundër anëtarëve të pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të marginalizuara.

Qeveria ndërmori masa për t'i identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zyrtarët që kishin kryer abuzime të të drejtave të njeriut, por nganjëherë i mungonte konsistenca. Shumë veta në qeveri, opozitë, shoqëri civile dhe media raportuan raste të zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion ose që vepronin pa u ndëshkuar. Qeveria nganjëherë i suspendonte ose i largonte shkelësit nga detyra, dhe sektori i drejtësisë nganjëherë ndërmerre hapa për t'i ndjekur penalisht dhe ndëshkuar ata zyrtarë që kishin kryer abuzime, shkelje dhe krime. Megjithatë, shumë zyrtarë të korruptuar vazhduan të mbanin poste në sektorin publik.

### **Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:**

#### **A. PRIVIMI ARBITRAR I JETËS DHE VRASJET E PALIGJSHME APO TË MOTIVUARA POLITIKE**

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme. Inspektorati Policor është përgjegjës për hetimin e akuzave për vrasje arbitrare ose të paligjshme nga qeveria ose agjentët e saj, dhe Prokuroria e Shtetit është përgjegjëse për ndjekjen penale të rasteve të tilla. Mandati i saj aktual i ripërtërirë vazhdon deri në qershor 2021.

Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) monitoron raste të përzgjedhura penale e civile dhe gjykime në sistemin gjyqësor, e këshillon Shërbimin Korrektues dhe ofron mbështetje logjistike për Dhomat e Specializuara në Hagë. Ai kishte disa përgjegjësi të kufizuara ekzekutive në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe shërbeu si reagues i dytë i sigurisë në mbështetje të policisë.

Që nga shtatori, 101 raste të krimeve të luftës ishin nën hetim zyrtar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK). Gjatë këtij viti, PSRK-ja lëshoi një aktvendim për fillimin e një hetimi.

Dy nga rastet nën hetimin e PSRK-së, të referuara si rastet e krimeve të luftës “Drenica”, përfshinin 15 ish-anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të dyshuar për krime lufte kundër civilëve. Akuzat përfshijnë torturim, keqtrajtim të të burgosurve dhe vrasje, të gjitha gjoja të kryera në një qendër paraburgimi të UÇK-së në fshatin Likoc në rajonin e Drenicës në vitin 1998. Rastet fillimisht rezultuan në 11 dënime në vitin 2015. Gjashtë nga të dënuarit iu shmangën shërbimit të burgimit deri në korrik 2019, kur gjykata i ktheu ata në burg. Një rast tjetër i krimeve të luftës, i njohur si çështja “Drenica I”, u dërgua për rigjykim në vitin 2017, por seanca fillestare, e caktuar të mbahej në dhjetor 2019, nuk u mbajt sepse qeveria nuk e paraqiti dëshmitarin e vet të mbrojtur. Seanca e radhës u caktua të mbahej në dhjetor 2020, një vit pasi seanca fillestare ishte anuluar, dhe nuk ishte mbajtur deri në fund të vitit.

Në qershor, Gjykata Themelore e Prizrenit e dënoi Darko Tasiqin, një serb i zhvendosur, me 22 vjet burg për krime lufte të kryera kundër shqiptarëve etnikë në vitin 1999 në fshatin Krushë e Vogël të komunës së Prizrenit. Ai u akuzua edhe për pjesëmarrje në konfiskim, grabitje, përdhosje të mbetjeve njerëzore dhe shkatërrim të paligjshëm e të qëllimshëm të pronës. Sipas raporteve të mediave, një grup i të rinjve shqiptarë të Kosovës u përpoq të hynte në stacionin e policisë prapa gjykatës gjatë dënimit të tij, duke u përleshur më pas me policinë pasi një grup e sulmoi automjetin në të cilin transportohej Tasiqi. OJQ-ja Qendra për të Drejtën Humanitare raportoi se aktgjykimi i tejkaloj maksimumet ligjore. Në dhjetor, Gjykata e Apelit ia uli dënimin në 11 vjet, brenda maksimumit ligjor.

## KOSOVA

Në qershor mediat raportuan se Gjykata Supreme vendosi që aktgjykimet me të cilat lirohej të Millorad Zaijiq nga përfshirja në vrasje dhe dëbime të shqiptarëve etnikë gjatë luftës në vitin 1998 ishin të pasakta, por Gjykata Supreme nuk ishte në gjendje të urdhëronte rigjykim të rastit, pasi nuk mund ta rrëzonte një vendim të formës së prerë në dëm të të pandehurit. Zaijiq u lirua nga Gjykata Themelore në Pejë në mars 2019 për vrasjen e dy personave dhe dëbimin e shqiptarëve etnikë nga një fshat gjatë luftës në Kosovë në vitin 1998 si anëtar i një grupi të armatosur. Në tetor 2019, Gjykata e Apelit e mbështeti lirim. Një gjykatës i Gjykatës së Apelit citoi dëshmitë “kundërthënëse” të dëshmitarëve të gjykimet si arsye për lirim e Zaijiqit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPSK), me seli në Hagë, janë institucione të Kosovës, të krijuara me ligjin e Kosovës dhe me gjykatës, prokurorë dhe zyrtarë ndërkombëtarë. ZPSK-ja dhe DHSK-ja vazhduan t’i hetonin krimet e kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. ZPSK-ja dhe paraardhësi i saj, Task Force Speciale Hetuese e BE-së, u themeluan pas lëshimit të raportit të Këshillit të Evropës në vitin 2011, *Trajtimi Çnjerëzor i Njerëzve dhe Trafikimi i Paligjshëm i Organeve të Njeriut në Kosovë*, i cili pretendonte për krime nga udhëheqësit individualë të UÇK-së. ZPSK-ja intervistoi disa personalitete kryesore nga periudha në fjalë, përfshirë presidentin e atëhershëm Hashim Thaçi. Në qershor, ZPSK-ja njoftoi se kishte ngritur padi në DHSK kundër Thaçit dhe Kryetarit të Kuvendit Kadri Veseli. Në nëntor, DHSK-ja konfirmoi një aktakuzë të ngritur nga ZPSK-ja me të cilën akuzoheshin Thaçi, Veseli dhe të tjerë për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Politikanët kryesorë dhe udhëheqësit kryesorë të shoqërisë civile, posaçërisht organizatat e veteranëve, publikisht e denoncuan ZPSK-në dhe DHSK-në dhe punuan për ta dobësuar mbështetjen e publikut për punën e ZPSK-së dhe DHSK-së. Këto përpjekje përfshinin protesta publike, një kërkesë për peticion për ta shfuqizuar gjykatën dhe një nismë legjislative të propozuar nga ish-presidenti Thaçi që mund ta kishte dëmtuar mandatin e DHSK-së.

## B. ZHDUKJA

Nuk pati raportime për zhdukje nga apo në emër të autoriteteve qeveritare.

Që nga shtatori, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur kishte të regjistruar 1.640 persona të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë konfliktit të vitit 1998-99 dhe dhuna politike që pasoi. Sipas ligjit, databaza qeveritare për persona të zhdukur nuk përfshin prejardhjen etnike të personave të zhdukur, përveç nëse vullnetarisht raportohet nga familja e tyre. Komisioni sugjeroi që rreth 70 për qind ishin shqiptarë dhe 30 për qind ishin serbë, romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë, goranë, malazezë dhe të tjerë.

Gjatë këtij viti, Komisioni zgjodhi tri raste të personave të zhdukur që i përkisnin komunitetit shqiptar dhe ua dorëzoi eshtrat e tre personave familjeve të tyre. Në nëntor, imazhet satelitore në dispozicion të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq zbuluan mbetje njerëzore në

## KOSOVA

minierën e Kizhevakut në Serbi. Ekipet mjekoligjore nga Kosova, Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare filluan zhvarrosjet.

### **C. TORTURIMI DHE TRAJTIMET APO NDËSHKIMET E TJERA TË EGRA, ÇNJERËZORE APO POSHTËRUESE**

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë praktika të tilla, por ligjet nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe ka pasur pretendime të vazhdueshme që disa të arrestuar keqtrajtoheshin nga policia dhe, në një shkallë më të vogël, nga personeli i shërbimit korrektues.

Që nga tetori, Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës raportoi se kishte pranuar 21 ankesa të regjistruara, shtatë prej të cilave i plotësonin kriteret e pranueshmërisë, për keqtrajtim të të burgosurve: gjashtë ankesa kundër policisë dhe një kundër shërbimit korrektues. Inspektorati Policor i hetoi tri prej këtyre rasteve, ndërsa Institucioni i Avokatit të Popullit i shqyrtoi rastet e tjera. Institucioni i Avokatit të Popullit raportoi se pandemia COVID-19 e kufizonte aftësinë e tij për t'i ndjekur rastet.

Mekanizmi Kombëtar Parandalues kundër Torturës (MKPT), që vepron nën Institucionin e Avokatit të Popullit, i pezulloi përkohësisht, në mars, vizitat e tij në burgje, qendra të paraburgimit, objekte psikiatrike dhe stacione policore për shkak të masave lehtësuese COVID-19. Pandemia gjithashtu i pengoi kontaktet e të burgosurve me MKPT-në përmes avokatëve, anëtarëve të familjes dhe organizatave ndërkombëtare. Për ta siguruar mbrojtjen e të paraburgosurve, MKPT-ja ofroi katër numra të linjave telefonike që mundësonin qasje gjatë gjithë ditës me zyrtarët e MKPT-së dhe përdori kuti të sigurta për ankesat me shkrim në qendra të paraburgimit. Vetëm personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit ka qasje në këto thirrje telefonike dhe ankesa me shkrim. Para pezullimit të vizitave të veta në terren, MKPT-ja kreu 40 vizita në stacione policore, burgje, objekte psikiatrike, shtëpi të kujdesit shoqëror dhe institucione të përdorura për karantinë. Ai nuk pranoi asnjë akuzë për torturë ose keqtrajtim nga personat në ndalim policor gjatë vizitave të MKPT-së. MKPT-ja paraqiti raporte mbi gjetjet e veta, kreu hetime dhe publikoi raporte përcjellëse mbi pajtueshmërinë e qeverisë.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT), OJQ-ja kryesore e vendit për çështje që lidhen me torturat, realizoi tetë vizita në qendra të paraburgimit dhe raportoi se nuk kishte pranuar asnjë raport të besueshëm për tortura gjatë vitit, ndonëse raportoi se keqtrajtimi i të burgosurve vazhdoi të mbetej problem.

Në qershor, Inspektorati Policor hetoi një ankesë të paraqitur nga një i arrestuar, në të cilën theksonte se ishte grushtuar në kokë nga policia, duke i shkaktuar gjakderdhje. Sipas ankesës, incidenti ndodhi pas arrestimit dhe transferimit të tij në stacionin policor në Prishtinë. Pas hetimit, polici u suspendua nga policia, u vendos në paraburgim dhe IPK-ja paraqiti kallëzim penal për sjellje të keqe.

## KOSOVA

Në korrik, Inspektorati Policor i suspendoi dy policë nga stacioni policor i Pejës pas ankesave për keqtrajtim të një djalë 16-vjeçar. I mituri u arratis nga policia dhe pasi u kap, sipas ankesës, policia e abuzoi duke përdorur sprej piperi, duke e shkelmuar në brinjë, duke e grushtuar në kokë dhe fytyrë, duke e lidhur me pranga dhe duke e fyer në automjetin e policisë.

Qeveria nganjëherë hetonte abuzimin dhe korrupsionin, ndonëse mekanizmat për ta bërë këtë nuk ishin gjithmonë efektivë ose i nënshtroreshin ndërhyrjes politike. Forcat e sigurisë nuk siguruan respektim të urdhrave të gjykatës kur zyrtarët lokalë nuk i zbatonin ato. Edhe pse disa policë u arrestuan nën akuzat për korrupsion gjatë vitit, pandëshkueshmëria mbeti problem.

Inspektorati Policor është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave lidhur me sjelljen e policisë. Deri në gusht, ai kishte hetuar 360 policë në lidhje me 935 ankesa të qytetarëve për sjellje të policisë. Inspektorati gjeti shkelje disiplinore në 545 prej këtyre ankesave dhe ia përcolli ato Njësisë së policisë për Standarde Profesionale. Gjatë vitit, Inspektorati hetoi 23 raste penale nga viti 2019 dhe ngriti 29 kallëzime penale për shkelje disiplinore.

### **KUSHTET NË BURGJE DHE QENDRA TË NDALIMIT**

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit i plotësonin disa standarde ndërkombëtare, por pati probleme në burgje, posaçërisht dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni, ekspozimi ndaj pikëpamjeve radikale fetare apo politike dhe kujdesi mjekësor nën standarde.

Kushtet fizike: Kushtet fizike mbetën nën standard në disa reparte të Burgut të Dubravës. QKRVT-ja vërejti rënie të ndjeshme të popullatës së burgjeve që nga fillimi i pandemisë COVID-19 dhe theksoi se mbipopullimi nuk ishte më problem në institucionet korrektuese. Ulja e numrit të popullatës ishte, me sa duket, për shkak të uljes së shkallës së dënimeve për shkak të situatës që lidhej me COVID-19 në procedura gjyqësore dhe ngurrimit të madh të gjykatësve për t'i dërguar të burgosurit në paraburgim gjatë pandemisë. Kushtet fizike në qendrën e paraburgimit në Pejë nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare, sipas MKPT-së, për shkak të mungesës së dritës natyrore dhe ventilimit joadekuat në qeli. Disa të meta të ngjashme vazhduan edhe në qendrën e paraburgimit në Prizren.

QKRVT-ja raportoi se autoritetet ofruan mbrojtje adekuate si për të burgosurit, ashtu edhe për zyrtarët korrektues. QKRVT-ja pranoi ankesa nga të burgosurit që pretendonin ngacmim verbal, dhunë ndërmjet të burgosurve dhe disa raste të keqtrajtimit fizik nga zyrtarët korrektues, kryesisht në njësinë e të miturve në Burgun e Dubravës dhe në qendrën korrektuese në Lipjan. QKRVT-ja raportoi se zyrtarët e Qendrës Korrektuese në Lipjan ua hoqën dyshekët disa të burgosurve të mitur në izolim gjatë orëve të ditës si masë disiplinore dhe theksoi se kjo i shkel standardet për trajtimin e të miturve. QKRVT-ja vërejti raste kur të burgosurit shantazhonin dhe ngacmonin të burgosurit e tjerë në Burgun e Dubravës. QKRVT-ja raportoi se të burgosurit dhe të paraburgosurit kishin vështirësi në marrjen e kujdesit mjekësor. Kishte pohime për korrupsion dhe përdorim të transferimeve ndërmjet institucioneve të paraburgimit si masa disiplinore. QKRVT-ja raportoi se të dënuarit herë pas here e dëmtonin veten për ta tërhequr

## KOSOVA

vëmendjen ndaj nevojave të tyre, përfshirë kujdesin mjekësor, transferimet ose privilegjet. QKRVT-ja raportoi raste të pretenduara të korrupsionit dhe nepotizmit, përfshirë nga personeli korrektues dhe shëndetësor, posaçërisht në qendrën korrektuese në Dubravë.

Që nga shtatori, MKPT-ja kishte pranuar 14 raporte mjekësore nga autoritetet shëndetësore të burgjeve për dëmtim të të burgosurve për shkak të dhunës ndërmjet të të burgosurve dhe katër raste të të burgosurve që pretendonin dëmtime të marra nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja i kontrolloi dosjet mjekësore të dërguara nga autoritetet, por për shkak të kufizimeve për COVID-19 nuk ishte në gjendje t'i vizitonte dhe intervistonte të burgosurit e përfshirë në incidentet e supozuara.

Pas dorëzimit të një raporti mjekoligjor zviceran tek autoritetet në fund të vitit 2019, kryeprokurori i shtetit rihapi hetimin mbi vdekjen në burg në vitin 2016 të aktivistit të partisë Vetëvendosje, Astrit Dehari, dhe ia caktoi çështjen Prokurorisë Speciale të Kosovës. Dehari u arrestua nën dyshimin për përfshirje në një sulm ndaj parlamentit. Autoritetet hetuan nëse Dehari bëri vetëvrasje, por anëtarët e familjes së tij dhe përfaqësuesit e partisë Vetëvendosje pohuan që ai u vra për shkak të aktivizmit të tij politik. Qeveria kërkoi ndihmën zvicerane në vitin 2018; raporti zviceran i vitit 2019 theksoi se analiza mjekoligjore nuk mund të përjashtonte shkaqe të tjera të mundshme të vdekjes dhe rekomandoi hetime të mëtejme. Në fund të vitit hetimi i kësaj çështjeje ishte duke vazhduar.

Për shkak të trajnimit të dobët dhe stafit të pamjaftueshëm, autoritetet nuk ushtronin gjithmonë kontroll ndaj objekteve ose të burgosurve. Kishte mungesë të stafit të trajnuar për t'i lehtësuar programet për trajtim të të varurve nga droga. Nuk kishte asnjë testin të varësisë nga droga brenda shërbimit korrektues dhe sistemi i klasifikimit të të burgosurve me çështje të lidhura me varësinë nga droga nuk ishte plotësisht funksional. QKRVT-ja raportoi se droga, kryesisht marihuanë, kontrabandohej rregullisht në këto objekte, përkundër ndalimit të vizitave personale për të burgosurit për shkak të pandemisë COVID-19. Një anëtar i stafit u kap duke kontrabanduar drogë për të burgosurit.

QKRVT-ja dokumentoi vonesa dhe gabime në ofrimin e kujdesit mjekësor për të burgosur, si dhe mungesën e trajtimit të specializuar jashtë institucioneve korrektuese, posaçërisht në Burgun e Dubravës. Në shumë raste, këto kushte i detyruan të burgosurit t'i blinin barërat e nevojshme përmes burimeve private. QKRVT-ja vërejtë të meta në sistemin e kujdesit shëndetësor në Burgun e Dubravës dhe raportoi për numër të pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për sigurimin e kujdesit mjekësor dhe të personelit shëndetësor në objektet korrektuese.

Objektet dhe trajtimi për të burgosur me aftësi të kufizuara mbetën nën standarde. Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës ofronte trajtim dhe strehim të kufizuar për të paraburgosur me aftësi të kufizuara mendore. Edhe pse të paraburgosurit mbaheshin ndaras nga të burgosurit e dënuar, avokatët e personave me aftësi të kufizuara e fajësonin qeverinë që rregullisht i vendoste të paraburgosurit me aftësi të kufizuara mendore bashkë me të paraburgosurit e tjerë.

## KOSOVA

Ligji kërkon që kriminelët e dënuar, me probleme të dokumentuara të shëndetit mendor, të mbahen në objekte të dedikuara për kujdes të shëndetit mendor, por këta të burgosur shpesh vendoseshin në burgje standarde për shkak të mbingarkesës në institucionet e shëndetit mendor. QKRVT-ja raportoi për përafërsisht 30 të burgosur mbi moshën 60 vjeçare, të cilët nuk ishin vendosur siç duhet, në bazë të paaftësisë së tyre specifike mendore. Përveç terapisë me barëra dhe konsultimeve të rregullta me psikiatër, të burgosurve me probleme të shëndetit mendor nuk u sigurohej ndonjë veprimtari profesionale apo terapeutike.

Kushtet në burgje për luftëtarët e huaj terroristë dhe të dënuarit për vepra terroriste nuk dallonin shumë nga kushtet e të burgosurve në burgjet e përgjithshme

Administrata: Autoritetet nuk zhvillonin gjithmonë hetime të duhura për keqtrajtim. QKRVT-ja theksoi se mekanizmi i brendshëm për ankesa (në krahasim me mekanizmin e MKPT-së), i paraparë me ligj, nuk funksiononte në mënyrës efikase; zyrtarët u përgjigjeshin shumë ngadalë ankesave. Përveç kësaj, të burgosurit shpesh nuk i lajmëronin abuzimet për shkak të mungesës së konfidencialitetit dhe frikës nga hakmarrja. Megjithatë, QKRVT-ja gjithashtu theksoi se autoritetet nuk u ofronin rregullisht të burgosurve vendime me shkrim me të cilat arsyetohej izolimi në vetmi dhe informata për afatet e ankesave. QKRVT-ja theksoi mungesën e përgjigjes nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues lidhur me kërkesat e të burgosurve për transferim.

Monitorimi i pavarur: Ndonëse të gjitha vizitat u penguan për shkak të rrethanave të COVID-19, Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur të të drejtave të njeriut, por vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit dhe EULEX-i kishin qasje të pakufizuar në institucionet korrektuese gjatë gjithë vitit. QKRVT-ja dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut duhej të njoftonin 24 orë më parë për vizitat e planifikuara.

Përmirësimet: QKRVT-ja raportoi për përmirësime në kushtet e strehimit për shkak të disa rinovimeve në Burgun e Dubravës dhe Burgun e Sigurisë së Lartë në Prishtinë, si dhe hapjes së objekteve të reja në qendrën korrektuese të Prishtinës. QKRVT-ja theksoi se Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka punësuar personel shtesë gjatë vitit.

Të burgosurve u mundësua qasja në Skype dhe aplikacione të tjera të video komunikimit dhe leja për të komunikuar me familjet e tyre. QKRVT-ja raportoi se disa të dënuar morën leje për punësim jashtë institucioneve korrektuese, duke përmirësuar mirëqenien fizike, mendore dhe ekonomike të të dënuarve dhe të familjeve të tyre. Qendra Korrektuese e Grave prodhoi maska anti-COVID për të gjitha qendrat korrektuese.

Përmirësimet administrative përfshinin një pilot program për ta përmirësuar vlerësimin dhe klasifikimin e rasteve penale. QKRVT-ja gjithashtu theksoi se Shërbimi Korrektues nxori standarde disiplinore për t'i përshkruar masat specifike disiplinore, kohëzgjatjen dhe arsyetimin e tyre, dhe për të dhënë këshilla ligjore për ankesat e të burgosurve.

### D. ARRESTIMI OSE NDALIMI ARBITRAR

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikojnë të drejtën e çdo personi për ta kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij/saj në gjykatë. Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa. Personeli i EULEX-it dhe i KFOR-it nuk i nënshtrohej sistemit ligjor të vendit, por masave disiplinore të misionit dhe të vendeve të tyre përkatëse.

### PROCEDURAT E ARRESTIMIT DHE TRAJTIMI I TË NDALUARVE

Sipas ligjit, përveç kur krimi është në zhvillim e sipër, policia mund të arrestojë të dyshuar vetëm me urdhra të bazuar në prova dhe të lëshuar nga një gjykatës ose prokuror. Brenda gjashtë orëve pas arrestimit, prokurorët duhet t'ia lëshojnë personit të arrestuar një deklaratë me shkrim ku përshkruhen vepra e dyshuar dhe baza ligjore për akuza. Autoritetet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjykatësit brenda 48 orëve dhe duhet t'u sigurojnë të ndaluarve qasje në avokatin të cilin e zgjedhin apo në avokatin e siguruar nga shteti. Ekziston edhe sistemi i dorëzarisë, por rrallë përdoret nga gjykatat. Ato shpesh i lironin të ndaluarit pa dorëzani, në pritje të gjykimit.

Të dyshuarit kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në të gjitha fazat e hetimit, përveç pyetjeve për identitetin e tyre. Të dyshuarit kanë të drejtë për ndihmë falas të avokatit dhe të përkthyesit, dhe për trajtim mjekësor e psikologjik. Në të gjitha fazat e hetimit, të dyshuarit mund të komunikojnë me përfaqësuesin e tyre ligjor dhe ta njoftojnë një anëtarë të familjes për arrestimin e tyre.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga data e arrestimit, dhe mund ta vazhdojë paraburgimin deri në një vit. Pas ngritjes së aktakuzës e deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjykatësi i rastit apo trupi gjykues mund ta caktojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon që gjykatësi të urdhërojë arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzarisë si alternativa ndaj paraburgimit.

Ndonëse në disa raste policët ishin sekretë, ata në përgjithësi i kryenin arrestimet duke përdorur urdhërarreste. Nuk pati raportime të konfirmuara që policia abuzoi rregullin 48-orësh, dhe prokurorët në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar dokumente në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Ndonëse zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për vendosje të shpejtë të rasteve, QKRVT-ja raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët përkohësisht nuk ishin në dispozicion.

QKRVT-ja raportoi se autoritetet nuk i lejonin gjithmonë personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit dhe në disa raste u lejonin konsultime me avokat vetëm pasi hetuesit policorë kishin filluar marrjen formale në pyetje. Në disa raste, të ndaluarve iu lejua

## KOSOVA

gasja në avokat vetëm pas marrjes formale në pyetje. Disa të ndaluar ankoheshin që, përkundër kërkesës për avokat, kontakti i tyre i parë me avokatin ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë.

Ligji ia kufizon policisë përdorimin e forcës vetëm për ta “mbrojtur jetën e një personi, për ta parandaluar një sulm, për ta parandaluar një vepër penale, për ta parandaluar arratisjen e kryesit ose, kur masat e tjera nuk janë të suksesshme, për ta arritur një synim tjetër të ligjshëm policor”. Ligji gjithashtu parashikon që kur përdoret forca, policia “do të përpiqet ta minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e një personi dhe ta minimizojë çdo pasojë të dëmshme”.

Paraburgimi: Paraburgimet e gjata, mesatarisht gjashtë muaj, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji u lejon gjykatësve ta ndalojnë të pandehurin në pritje të gjykimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka të ngjarë t'i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat, të ndikojë në dëshmitarë, të ikën, ta përsërisë veprën penale, të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar arsyetim të mbështetur në prova. Paraburgimi i gjatë ndodhte gjithashtu për shkak të joefikasitetit dhe korrupsionit në gjyqësor.

### **E. MOHIMI I GJYKIMIT TË DREJTË PUBLIK**

Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, por gjyqësori nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Sipas Komisionit Evropian, OJQ-ve dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, administrimi i drejtësisë ishte i ngadalshëm dhe i mungonin mjetet për të siguruar llogaridhënie nga zyrtarët gjyqësorë. Strukturat gjyqësore i nënshtroheshin ndërhyrjes politike, me emërime të diskutueshme dhe mandate të paqarta.

Ndonëse numri i lëndëve të grumbulluara dikur paraqiste problem të madh, efikasiteti i gjyqësorit për t'i zgjidhur lëndët e grumbulluara u përmirësua dukshëm. Numri i lëndëve të pazgjidhura në gjykatat themelore është zvogëluar për 85 për qind që nga viti 2016.

Këshilli Gjyqësor përmirësoi faqen e tij të internetit duke shtuar një modul të përgjegjësisë gjyqësore që përfshin udhëzime për ngritjen e një ankese kundër një gjykatësi ose një zyrtari të gjykatës. Këshilli lëshoi vërejtje jopublike me shkrim ose ulje të pagave për tre gjykatës, edhe pse këto sanksione u konsideruan të pamjaftueshme për ta parandaluar ndjeshëm sjelljen e keqe në të ardhmen. Këshilli Prokurorial nisi pesë hetime dhe lëshoi pesë vendime, tri prej të cilave ishin konstatime të fajit. Të dy këshillat i publikuan këto vendime në faqet e tyre përkatëse të internetit.

Autoritetet nganjëherë nuk i respektuan urdhrat e gjykatave, përfshirë urdhrat e Gjykatës Kushtetuese, posaçërisht kur aktvendimet ishin në favor të pakicave, si në shumë raste të kontesteve pronësore të serbëve të Kosovës. Autoritetet qendrore e lokale në Deçan vazhduan ta refuzonin zbatimin e vendimit të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese që konfirmonte

## KOSOVA

pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe për më tepër se 24 hektarë tokë afër Manastirit të Deçanit. Asnjëri prej zyrtarëve të përfshirë në moszbatimin e urdhrin të gjykatës nuk është sanksionuar.

### **PROCEDURAT E GJYKIMIT**

Ligji parashikon gjykim të drejtë e të paanshëm dhe, edhe pse pati të meta të mëdha në sistemin e drejtësisë, përfshirë rastet e ndërhyrjes politike, ligji në përgjithësi u respektua. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre, për gjykim të drejtë, me kohë e publik ku gjykatës mund t'i drejtohen në gjuhën e vet amtare, të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të heshtin dhe të mos detyrohen të dëshmojnë apo pranojnë fajësinë, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Këto të drejta u ofrohen të gjithë qytetarëve pa përjashtim. Vendi nuk mban gjykime me juri.

Kushtetuta përcakton ndihmën juridike falas si të drejtë themelore të njeriut dhe ligji garanton ndihmë juridike falas në çështjet civile, çështjet administrative, kundërvajtjet dhe procedurat penale për individët që përmbushin kriteret e caktuara ligjore dhe financiare. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), e mandatuar nga qeveria, ofron ndihmë juridike falas për individë me të ardhura të ulëta. Gjatë vitit, ANJF-ja ndërmori fushata në terren duke synuar komunitetet e cenuara e të marginalizuara dhe shpërndau informacione për ndihmë juridike përmes platformave online.

### **TË BURGOSURIT DHE TË ARRESTUARIT POLITIKË**

Nuk pati raportime për të burgosur apo të arrestuar politikë.

### **PROCEDURAT DHE MJETET JURIDIKE CIVILE**

Ka mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut, por viktimat nuk mund ta shfrytëzonin këtë të drejtë për shkak të procedurave të ndërlikuara burokratike dhe numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me kushtetutë, por vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve të tjera juridike.

Institucioni i Avokatit të Popullit pranoi 12 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore lidhur me kontestet civile, pronësore ose të punësimit. Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi që Këshilli Gjyqësor t'i jepte përparësi rigjykimin ndaj rasteve të reja.

### **RIKTHIMI I PRONËS**

## KOSOVA

Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe ankesat e shumta për të njëjtën pronë, vazhduan ta pengonin zgjidhjen e rasteve të rikthimit të pronës që buronin nga lufta dhe pas saj. Mbi 96 për qind të këtyre ankesave ishin parashtruar nga serbët. Qytetarët e rëndomtë dhe komunitetet fetare nuk ishin shumë të suksesshëm në paraqitjen e kërkesave për rikthim të pronës së sekuestruar apo të konfiskuar gjatë kohës së Jugosllavisë.

Sipas ligjit, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) ka autoritetin t'i gjykojë pretendimet lidhur me shtrirjen, vlerën dhe pronësinë e parcelave të tokës dhe t'i zgjidhë mospërputhjet ndërmjet dokumenteve kadastrale. Megjithatë, mungesa e regjistrave kadastrale, që Serbia i largoi nga Kosova në vitin 1999, e pengoi AKKVP-në që ta përmbushte plotësisht mandatin e saj. Parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të ankohen në gjykata kundër vendimeve.

AKKVP-ja kishte vështirësi në zbatimin e vendimeve për dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm dhe në përgjithësi dështoi në largimin e strukturave ilegale të ndërtuara në tokë pasi parashtruesve të kërkesave u ishte konfirmuar e drejta e tyre. Shumica e parashtruesve të kërkesave ishin serbë. Në fill, Agjencia miratoi një udhëzim administrativ për ta përshpejtuar largimin e strukturave ilegale. Si rezultat, një rrënim ndodhi në tetor në Prishtinë. Agjencia raportoi se filloi kompensimin në 143 raste për ata që e humbën pronën në vitet 1990, kryesisht shqiptarë. Deri në tetor, AKKVP-ja kishte 61 dëbime në pritje, prej të cilave 23 ishin në rajonin e Mitrovicës, ku përfshihej kryesisht prona në pronësi të shqiptarëve. Riuzurpimi i pronës vazhdoi të mbetej problem, ndonëse thuhet që rastet e rizënies së pronës kanë shënuar rënie. Organizatat e shoqërisë civile janë ankuar se vendit i mungon një sistem efektiv për t'u mundësuar serbëve të zhvendosur nga Kosova, që jetonin jashtë vendit, për të paraqitur kërkesa pronësore dhe për të marrë njoftime lidhur me vendimet për kërkesa pronësore.

Në vitin 2019, Kuvendi emëroi Naser Shalën për kryetar të AKKVP-së. Shala nuk ishte në gjendje të sigurote emërimin nga parlamenti në këtë pozitë në vitin 2018 për shkak të pikëpamjeve të përhapura se ai ishte i korruptuar, i pakualifikuar dhe nën hetim penal. Shala mbeti në detyrë pavarësisht thirrjeve të shumta ndërkombëtare për dorëheqjen e tij, duke zvogëluar kështu besueshmërinë e institucionit.

Më 4 shtator, Kryeministri Hoti dhe Presidenti serb Vuçiq nënshkruan marrëveshje që përfshinin zotimet për ta vazhduar rikthimin e pronës hebreje të patrashëgimtarë dhe të pakërkuar të kohës së Holokaustit.

## **F. NDËRHYRJA ARBITRARE OSE E PALIGJSHME NË INTIMITET, FAMILJE, SHTËPI APO KORRESPONDENCË**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe nuk pati raportime që Qeveria, EULEX-i apo KFOR-i nuk i respektuan këto ndalesa.

### Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, përfshirë:

#### A. LIRINË E FJALËS DHE TË SHTYPIT

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë e shtypit. Ndonëse Qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë, pati raportime të besueshme që disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe radikale fetare përpiqeshin t'i kërcënonin përfaqësuesit e mediave. Problemet financiare gjithashtu kërcënuan pavarësinë e mediave. Gazetarët hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike, pavarësisht ligjeve që sigurojnë qasje në dokumente publike, për shkak të vonesave në miratimin e rregulloreve zbatuese. Komisioni i Pavarur për Media i rregullon frekuencat e transmetimit, lëshon licenca për transmetuesit publikë dhe privatë dhe vendos për politikat e transmetimit.

Liria e fjalës: Në dhjetor 2019, ish-ministri i administratës së pushtetit lokal, Ivan Teodosije viq, u dënua me dy vjet burg për mohimin e një masakre të kohës së luftës të shqiptarëve etnikë në vitin 1999. Gjykata vendosi që fjalët e Todosijeviqit nxitnin urrejtje dhe jotolerancë, ndërsa mbrojtja e tij argumentoi se nuk kishte asnjë bazë ligjore për një vendim të tillë. Deri në tetor, ankesa e tij ishte në pritje.

Shtypi dhe mediat, përfshirë mediat elektronike: Mediat e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim. Megjithatë, pati raportime që zyrtarë qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me Qeverinë, grupe fetare dhe individë të pakënaqur ushtruan presion ndaj pronarëve të mediave, redaktorëve individualë dhe reporterëve për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara. Disa gazetarë u përmbajtën nga raportimi kritik hulumtues për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike ose sigurinë e punës.

Ndonëse disa medime financiarisht të pavarura zhvilluan politika redaksionale dhe transmetuese të pavarura nga interesat politike dhe afariste, mediumet me më pak burime nganjëherë pranuan ndihmë financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve. Sipas disa redaktorëve, financimi ishte i kufizuar pjesërisht për shkak të ngurrimit të qeverisë për t'i reklamuar programet e saj në media që publikonin materiale kritike për politikat e qeverisë.

Dhuna dhe ngacmimi: Që nga shtatori, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe mediat raportuan për 18 raste në të cilat zyrtarë qeveritarë, grupe afariste, grupe të komunitetit apo grupe radikale fetare cenuan lirinë e shtypit duke i sulmuar fizikisht ose kërcënuar gojarisht gazetarët.

Në mars një gazetar shqiptar i Kosovës u lëndua pasi autorë të panjohur e sulmuan atë dhe ekipin e tij gjersa po raportonin për situatën COVID-19 në veri të Kosovës. Mediat raportuan se policia arrestoi një person në lidhje me këtë incident.

## KOSOVA

Më 11 prill, kryeredaktorja e portalit në gjuhën serbe *KoSSev*, Tatjana Llazareviq, u arrestua nga policia gjersa po shkonte në një qendër shëndetësore për t'i hetuar ankesat që ajo mori në lidhje me gatishmërinë e qendrës për COVID-19. Edhe pse i paraqiti letrat e saj kredenciale si gazetare, Llazareviq u ndalua për të paktën një orë e gjysmë dhe u mbajt pa akuzë. Autoritetet e zbatimit të ligjit thanë se ajo u mor për shkak të shkeljes së orës policore, edhe pse qeveria i kishte liruar gazetarët nga kufizimi i lëvizjes që synonte ta ngadalësonte përhapjen e COVID-19. Llazareviq tha se arsyeja e vërtetë e arrestimit të saj ishte për ta frikësuar atë nga vazhdimi i raportimit të saj.

Më 18 tetor, vetura e gazetarit hulumtues, Shkumbin Kajtazi, u godit me plumba pak pasi ai e parkoi dhe u largua nga vetura. Ky ishte sulmi i dytë ndaj Kajtazit, vetura e të cilit ishte shënjestër e një sulmi të zjarrvënies në qershor, i cili u parandalua kur fqinjët e gazetarit e njoftuan policinë. Policia nuk i ka identifikuar publikisht të dyshuarit dhe nuk ka ngritur akuza për asnjërin rast.

Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes: Nuk pati raportime për censurim të drejtpërdrejtë të mediave të shkruara apo elektronike, megjithatë, gazetarët pohonin që presioni nga politikanët dhe grupet e organizuara kriminale shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike apo për vendin e tyre të punës. Gazetarët nganjëherë pranonin oferta të përfitimeve financiare në këmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi.

Sipas AGK-së, zyrtarët qeveritarë, si dhe kriminelë të dyshuar, gojarisht i kërcënonin gazetarët për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetatat që publikonin material kritik për ta.

Gazetarët u ankuan që pronarët dhe menaxherët e mediave nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë, partitë politike apo zyrtarë të caktuar. Në disa raste, gazetarët raportonin që pronarët e mediave i kërcënonin se do t'i largonin nga puna po të shkruanin raporte kritike. Gazetarët gjithashtu u ankuan që pronarët e mediave i ndalonin të raportonin për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

Që nga shtatori, Institucioni i Avokatit të Popullit hetoi 20 ankesa për shkelje të së drejtës për qasje në dokumente publike, shtatë prej të cilave u paraqitën nga organizatat e shoqërisë civile dhe 13 nga individët. Institucioni i Avokatit të Popullit arriti në përfundimin se institucionet publike nuk kishin kapacitet për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje në dokumente publike dhe shpesh dështuan të jepnin arsyetimin ligjor për mohimin ose kufizimin e qasjes.

## LIRIA E INTERNETIT

Qeveria nuk e kufizoi ose ndërpreu qasjen në internet apo censuroi përmbajtjen në internet, dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i monitoronte bisedat private në internet pa leje përkatëse ligjore.

## KOSOVA

### LIRIA AKADEMIKE DHE NGJARJET KULTURORE

#### B. LIRIA E TUBIMIT PAQËSOR DHE ASOCIIMIT

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit paqësor dhe asociimit, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

#### C. LIRIA E FESE

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi liritë fetare* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/religiousfreedomreport/>.

#### D. LIRIA E LËVIZJES

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

Qeveria nuk i konsideronte dokumentet personale të lëshuara nga Serbia, që mbanin emra të qyteteve të Kosovës, si dokumente të vlefshme udhëtimi, duke e vështirësuar kështu lirinë e lëvizjes për shumë anëtarë të komunitetit serb të Kosovës për të udhëtuar në Kosovë dhe nga Kosova, përveç nëse i përdornin dy vendkalimet kufitare me Serbinë të vendosura në komunat me shumicë serbe në veri. Përmirësimet në regjistrin civil në vitin 2018 dhe 2019 e zgjeruan dukshëm qasjen e serbëve të Kosovës në dokumente të identifikimit, dhe numri i serbëve të Kosovës që u pajisën me këto dokumente u rrit shumë gjatë këtij viti. Përfaqësuesit serbë të Kosovës pohuan se mbetën disa sfida, si qasja në dokumente civile për shtetasit serbë të martuar me qytetarët serbë të Kosovës.

Lëvizjet brenda vendit: Ura kryesore që lidh Mitrovicën veriore dhe jugore mbeti e mbyllur për qarkullim të veturave, gjoja për t'i parandaluar trazirat civile, por ishte plotësisht e hapur për këmbësorë. KFOR-i dhe policia mbajtën siguri të përhershme në atë lokacion. Urat e tjera që i lidhin këto dy qytete ishin plotësisht të hapura.

Mërgimi: Kthimi në vend i refugjatëve të pakicave etnike mbeti problem. Përfaqësuesit parlamentarë të komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom raportonin që paragjykimi shoqëror e pengonte kthimin e rreth 400 ashkalinjve, egjiptianëve dhe romëve. Këta persona më parë ishin banorë të këtij vendi dhe e informuan zyrën e UNHCR-së se ata ishin të gatshëm të ktheheshin nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

#### E. STATUSI DHE TRAJTIMI I PERSONAVE TË ZHVENDOSUR BRENDË VENDIT

UNHCR-ja vlerësoi se më shumë se 90.000 individë kishin nevoja të lidhura me zhvendosjen për shkak të konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, përfshirë 65.000 në Serbi, 16.406 në Kosovë,

## KOSOVA

7.500 në “vendet e treta”, 729 në Mal të Zi dhe 394 në Maqedoninë e Veriut. Ministria për Komunitete dhe Kthime nuk mbledh, përpunon apo menaxhon të dhëna për popullatën e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetarë. UNHCR-ja vazhdoi ta mirëmbajë bazën e vet të të dhënave të brendshme për të kthyerit dhe aplikacionet për ndihmë. Sipas Ministrisë për Komunitete dhe Kthime, pengesat për kthim përfshinin incidentet e sigurisë, mbrojtjen e pamjaftueshme të të drejtave pronësore, dështimin e gjykatave për t’i zgjidhur kontestet pronësore, mosbindjen ndaj vendimeve të gjykatës, mungesën e qasjes në shërbime publike, çështjet me zbatimin e të drejtave gjuhësore, perspektivat e kufizuara ekonomike dhe diskriminimin shoqëror. Sipas UNHCR-së, mungesa e një regjistrimi të detajuar dhe profilizimi i adekuat i të dhënave i lanë personat e zhvendosur pa mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe plane për zhvillim.

Qeveria promovoi kthimin e sigurt dhe vullnetar të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV). Përmes Ministrisë për Komunitete dhe Kthime, ajo promovoi politika dhe mbrojtje për PZHBV-të në përputhje me politikat e BE-së dhe bashkëpunoi me organizatat vendore e ndërkombëtare për ta siguruar qasjen e PZHBV-ve në pronat e tyre dhe në mjete për kthimin e tyre të qëndrueshëm. Këto përfshijnë ndihmën për riposedim të pronës, ndarjen e tokës për shtëpi, dhe perspektiva të përmirësuar socio-ekonomike.

Deri në dhjetor, Ministria për Komunitete dhe Kthime njoftoi se 273 individë – përfshirë 133 serbë, 42 goranë, 36 romë, 33 egjiptianë, 23 ashkalinj dhe pesë shqiptarë – ishin kthyer në vendin e tyre të origjinës në Kosovë. Që nga qershori, 408 të zhvendosur, kryesisht serbë të Kosovës, ishin duke jetuar në strehimore kolektive në tërë vendin. Ndërtimi i banesave të strehimit social për 255 PZHBV dhe refugjatë që banonin në pesë strehimore kolektive ishte në vazhdim, dhe projekti pritej të mbaronte në fund të vitit. Komunitat e Leposaviqit dhe Zveçanit ndanë tokë për ndërtimin e banesave sociale për banorët e mbetur të 10 strehimoreve kolektive, me financim që pritej nga BE-ja dhe Ministria për Komunitete dhe Kthime.

Deri në shtator, sipas një programi për kthim dhe riintegrim, të financuar nga BE-ja, dhe në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, Ministria për Komunitete dhe Kthime ndërtoi me sukses dhe kreu pranimin teknik të 53 shtëpive për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, me 38 shtëpi të tjera në ndërtim e sipër. Përveç kësaj, 65 përfitues të zgjedhur të shtëpive të sapondërtuara morën orendi dhe pajisje shtëpiake. Ministria për Komunitete dhe Kthime priste ta përfundonte ndërtimin e 101 shtëpive për të zhvendosurit dhe të kthyerit deri në fund të vitit. Si pjesë e të njëjtit program të BE-së, 100 përfitues morën ndihmë financiare për t’i filluar bizneset e tyre për të gjeneruar të ardhura. Ministria gjithashtu siguroi pako kujdesi për 872 familje të cenueshme.

Procesi i kthimit në disa zona të vendit vazhdoi të shënohej nga incidente të sigurisë dhe ngurrimi i komuniteteve lokale për ta pranuar kthimin e serbëve ose vizitat nga serbët e Kosovës. Në janar, shqiptarët në Gjakovë, përfshirë personat anëtarët e familjes së të cilëve mbeten të zhdukur, protestuan kundër pelegrinazhit të planifikuar të serbëve të zhvendosur në kishën ortodokse serbe të qytetit. Shoqata e pelegrinëve tha se vizitën e anuloi për shkaqe të

## KOSOVA

sigurisë. Që nga korriku, UNHCR-ja përmendi 45 incidente që ndikonin kryesisht në të kthyerit dhe në pronën e tyre, kryesisht në rajonin e Pejës. Për shembull, në prill, një automjet dhe bagëti iu vodhën një të kthyeri në rajonin e Istogut. UNHCR-ja tha se shënjestrat e incidenteve besohet të jenë serbët e Kosovës, përveç një rasti ku përfshihej një ashkali i kthyer.

Policia e Kosovës vazhdoi praninë e saj në zonat me pakica etnike dhe të kthyer si masë për ndërtimin e besimit për të kthyerit dhe për ta mbrojtur pronën e të kthyerve.

### F. MBROJTJA E REFUGJATËVE

Qasja në azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilit ose refugjatit me mbrojtje plotësuese, një sistem për t'u siguruar mbrojtje refugjatëve, dhe pranim të përkohshëm të azilkërkuesve gjersa rastet e tyre gjykohen. Vendi nuk ka sistem të menaxhimit të migracionit në nivelin qendror.

Objektet e pranimi në qendrën për azil mund të pranojnë fëmijë, por objektit i mungonin procedurat standarde të operimit për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar që kërkonin azil dhe për përcaktimin e të drejtës së tyre për azil. Megjithëse rastet e azilit kanë vazhduar të rriten, vendi është kryesisht vend tranzit. Ata që kërkonin azil zakonisht largoheshin nga vendi dhe nuk merrnin pjesë në seancat e tyre. Numri gjithnjë e më i madh i azilkërkuesve nuk e ka tejkaluar kapacitetin e vendit. Ata që kërkonin azil në vend vendoseshin në qendrën e azilit.

Përkundër një procesi të drejtpërdrejtë të regjistrimit, të sapoardhurve nuk u lejohej qasje e menjëhershme në shërbimet dhe procedurat e azilit, gjë që rezultoi në një numër të konsiderueshëm të kërkesave të pazgjidhura. Si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, prej marsit deri në qershor, UNHCR-ja avokoi për qasje të arsyeshme për azilkërkuesit dhe PZHBV-të gjatë ndalimeve të përkohshme të hyrjes ose mbylljes së kufijve të zbatuara nga qeveria. UNHCR-ja e pezulloi procesin e përcaktimit të statusit të refugjatit prej marsit deri në qershor për shkak të pandemisë COVID-19.

Deportimi: Në gusht 2019, inspektorati i policisë paraqiti kallëzim penal, ku përfshihej shkelja penale, kundër 22 policëve që morën pjesë në një operacion që përfshinte heqjen e lejeve të qëndrimit dhe deportimin pasues të gjashtë shtetasve turq në Turqi në mars 2018. Qeveria turke i kishte akuzuar qytetarët turq për lidhje me rrjetin Gulen. Në shtator 2019, Gjykata e Apelit konfirmoi një aktvendim paraprak se arsyetimi për heqjen e lejeve të qëndrimit ishte i pabazë. Deri në fund të vitit, Ministria e Punëve të Brendshme nuk kishte marrë asnjë vendim të formës së prerë nga gjykata.

Qasja në shërbimet themelore: UNHCR-ja raportoi se azilkërkuesit morën strehim, ushqim të rregullt dhe veshmbathje, ndërsa organizatat partnere të UNHCR-së ofruan vlerësime psikologjike, shërbime këshillimi dhe ndihmë juridike. Mungesa e shërbimeve të përkthimit për disa gjuhë zyrtare mbeti problem në nivelin qendror e lokal. UNHCR-ja pohonte që kujdesi shëndetësor dhe trajtimi psikologjik ende nuk ishin adekuat.

## KOSOVA

Qeveria bashkëpunoi me UNHCR-në për ta caktuar një qendër ndalimi për të huajt si një vend karantine për të sapoardhurit dhe për të siguruar pajisje mbrojtëse personale dhe sende higjienike për azilkërkuesit. UNHCR-ja siguroi qasje në shërbime të internetit në qendrat e azilit për t'u ofruar azilkërkuesve ndihmë ligjore dhe psikosociale në internet, si dhe arsimim për fëmijët.

Qeveria prezantoi rregullore që mandatojnë mbështetjen dhe integrimin për azilkërkuesit, refugjatët, personat me mbrojtje të përkohshme ose mbrojtje shtesë dhe personat pa shtetësi, por ende është duke i përfunduar procedurat standarde të operimit.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria u siguroi mbrojtje të përkohshme, të ashtuquajtur mbrojtje shtesë, individëve që mund të mos kualifikohen si refugjatë. Gjatë qershorit, qeveria i ofroi mbrojtje shtesë një personi.

### G. PERSONAT PA SHTETËSI

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese që mund të shkaktojnë që grupeve apo individëve t'u hiqet apo mohohet shtetësia. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet. Fëmijët e lindur nga prindërit që nuk janë shtetas të Kosovës e fitojnë shtetësinë për shkak të lindjes në vend; kjo më së shpeshti ndodh me anëtarët e komuniteteve pakicë, me numër të madh të banorëve, shtetësia e të cilëve nuk është dokumentuar. Procedurat e qeverisë parashikojnë qasje në natyralizim për personat që marrin statusin e personit pa shtetësi apo të refugjatit pesë vjet pas paraqitjes së kërkesës.

Ligjet që kanë të bëjnë me gjendjen civile u mundësojnë personave pa shtetësi t'i regjistrojnë lindjet, martesat dhe vdekjet, megjithatë, zbatimi i tyre ndryshonte nga komuna në komunë. Kapaciteti i qeverisë për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me shtetësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Në gusht, Institucioni i Avokatit të Popullit publikoi një mendim juridik sipas detyrës zyrtare për Gjykatën e Apelit, Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën Themelore në Pejë dhe Gjykatën Themelore në Mitrovicë, duke i inkurajuar që menjëherë t'i procedojnë paditë mbi identitetin juridik të personave të paregjistruar, posaçërisht të fëmijëve.

Gjatë vitit, UNHCR-ja u ndihmoi 900 personave "ligjërisht të padukshëm" (për shkak të pamundësisë së tyre për të ofruar dëshmi për vendin e tyre të lindjes) të grupeve të ndryshme etnike, shumica e të cilëve i takonin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Banorët e paregjistruar nuk marrin përfitime të ndihmës sociale, nuk kanë të drejtë në pension dhe nuk mund të regjistrojnë tituj pronësie ose t'i ruajnë të drejtat për pronë të trashëguar apo të transferuar. Fëmijëve të lindur nga prindërit e zhvendosur jashtë vendit dhe të cilët kanë hyrë me prindërit e tyre të ripranuar, shpesh u mungonte dokumentacioni, përfshirë certifikatat e

## KOSOVA

lindjes, nga vendi i tyre i lindjes. Autoritetet nuk kanë zhvilluar ndonjë zgjidhje sistematike për këtë problem. UNHCR-ja ofroi ndihmë juridike për regjistrimin civil të 133 romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të paregjistruar.

### **Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në proces politik**

Ligji parashikon të drejtën e qytetarëve për ta zgjedhur qeverinë e tyre përmes zgjedhjeve periodike të lira e të drejta, me votim të fshehtë, në bazë të votimit të përgjithshëm e të barabartë.

Qeveria serbe vazhdoi t'i drejtonte disa struktura paralele ilegale qeveritare në komunat me shumicë serbe dhe në zonat e banuara kryesisht nga komuniteti goran. Besohet që këto struktura shpesh përdorshin nga qeveria serbe për të ndikuar dhe manipuluar në komunitetet serbe dhe gorane dhe në përfaqësuesit e tyre politikë.

### **ZGJEDHJET DHE PJESËMARRJA POLITIKE**

Zgjedhjet e fundit: Vendi i mbajti zgjedhjet e parakohshme parlamentare në tetor 2019. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe të pavarur e vlerësuan procesin si përgjithësisht të lirë e të drejtë, ndonëse vëzhguesit e BE-së theksuan se keqpërdorimi i burimeve publike dhe mungesa e transparencës së financave të fushatës rezultuan në një fushatë të pabarabartë në të gjithë vendin. Fushata u përshkua me kërcënime brenda komunitetit serb të Kosovës. Disa serbë të Kosovës raportuan se ishin nën trysni për të mos mbështetur asnjë parti tjetër, përveç Listës Serbe, një parti e lidhur ngushtë me qeverinë serbe.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Në pjesën më të madhe të vendit, partitë politike vepruan lirshëm dhe nuk pati pengesa të mëdha për regjistrim. Në komunat me shumicë serbe, kandidatët e opozitës dhe të pavarur raportuan për presion ndaj kandidatëve të tyre për t'u tërhequr nga zgjedhjet dhe në votues për ta mbështetur Listën Serbe. Përfaqësuesit e opozitës serbe raportuan kërcënime për dhunë gjatë zgjedhjeve të majit 2019 për kryetarë komune nga përkrashtet e Listës Serbe dhe qeveria serbe. Përkatesia partiake shpesh luante rol në qasjen në shërbimet qeveritare dhe në mundësitë sociale dhe për punësim.

Pjesëmarrja e grave dhe e anëtarëve të grupeve të pakicave: Asnjë ligj nuk e kufizon pjesëmarrjen e grave apo të anëtarëve të pakicave në procesin politik dhe ata morën pjesë në to. Megjithatë, OJQ-të raportuan se pjesëmarrja e votuesve ndër gra ishte shumë më e ulët sesa ndër votuesit meshkuj. Partitë që përfaqësonin komunitetin rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, goran dhe turk bënë fushatë lirshëm në gjuhën e tyre amtare.

Një grua, Vjosa Osmani, shërbeu njëkohësisht si kryetare e Kuvendit dhe ushtruese e detyrës së Presidentit, dhe një e treta e të gjithë ministrave të kabinetit ishin gra. Në Kuvend, prej 120 deputetëve, 38 ishin gra, dy më shumë se kuota kushtetuese. Një raport i Freedom House i vitit 2020 theksoi se shumë grave në zonat rurale u është hequr e drejta e votimit përmes praktikës

## KOSOVA

së votimit familjar, me ç'rast kreu i shtëpisë votonte për tërë familjen. Partive politike u kërkohet ligjërisht ta respektojnë një kuotë gjinore prej 50 për qind në listat e tyre të kandidatëve, por asnjë parti nuk e përmbushi këtë kërkesë në vitin 2019.

Përfaqësimi i pakicave etnike në Kuvend ishte më shumë se proporcional me pjesën e tyre të popullsisë, por partitë politike që përfaqësonin pakicat etnike i kritikuan partitë shumicë që nuk u konsultuan me to për çështje të rëndësishme politike, si për projektligjin për Vlerat e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për vendimin e vitit 2018 për ta vendosur një tarifë prej 100 për qind për mallrat të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Vendimi për tarifën bëri që deputetët e Listës Serbe ta bojkotonin pjesëmarrjen në seancat e Kuvendit në vitin 2018 dhe 2019.

### **Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri**

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion ndaj zyrtarëve, por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. Zyrtarët nganjëherë përfshiheshin në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi. Rastet e korrupsionit shpesh i nënshtroheshin apelimit të përsëritur dhe sistemi gjyqësor shpesh lejonte parashkrimin e rasteve pa i gjykuar ato.

Korrupsioni: Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në qeveri. Që nga shtatori, PSRK-ja ngriti pesë aktakuza për korrupsion. Një pjesë e vogël e rasteve të korrupsionit që u hetuan dhe akuzuan çuan në dënime.

OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare pohuan për dështime të shumta nga sistemi gjyqësor për ta ndjekur penalisht korrupsionin, duke thënë se shumë pak raste të ngritura kundër zyrtarëve të lartë rezultojnë në aktakuza. Dënimi i zyrtarëve të nivelit të lartë të dënuar për korrupsion shpesh ishte i butë. Instituti i Kosovës për Drejtësi raportoi se dy zyrtarë të profilit të lartë u dënuan për korrupsion gjatë vitit nga gjykatat themelore, por më pas u liruan nga Gjykata e Apelit. Në katër raste të tjera, Gjykata e Apelit i rrëzoi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta kundër zyrtarëve të lartë publikë të akuzuar për korrupsion dhe i ktheu rastet në rigjykim. OJQ-të raportuan se aktakuzat shpesh dështonin, sepse prokurorët ngrinin akuza të pasakta ose bënin gabime procedurale.

Në së paku katër raste të profilit të lartë të korrupsionit, Gjykata Supreme gjeti se gjykatat më të ulëta e kishin shkelur kodin penal në dobi të të pandehurve. Prokuroria përdori mjete të jashtëzakonshme juridike për të kërkuar që Gjykata Supreme t'i vlerësonte vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta në këto raste. Sipas ligjit, Gjykata Supreme vetëm mund t'i konfirmojë shkeljet; ajo nuk mund të ndërmarrë veprime ndëshkimore kundër të pandehurve.

Më 9 tetor, policia arrestoi Haki Rugovën, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Istog dhe një nga nënkryetarët e partisë, bashkë me zëvendësin e tij dhe një nëpunës civil

## KOSOVA

komunal, si pjesë e një hetimi në vazhdim e sipër për korrupsion. Pasi Rugova fillimisht u vu në paraburgim, gjykata përfundimisht i urdhëroi Rugovës arrest shtëpiak për 30 ditë. Të tre personat u akuzuan për keqpërdorim të detyrës, konflikt të interesit dhe falsifikim të dokumenteve për një kontratë që komuna ia dha vëllait të kryetarit. Rugova po gjykohej për edhe një çështje tjetër nën akuzat për konflikt të interesit. Në komentet publike, kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, pohoi se arrestimi ishte me motive politike, duke deklaruar se kishte për qëllim diskreditimin e Rugovës dhe të partisë, dhe zbehjen e luftës kundër korrupsionit të qeverisë së udhëhequr nga Kryeministrit Hoti i LDK-së. Disa komentatorë ligjorë i konsideruan komentet e Mustafës si ndërhyrje në procesin gjyqësor.

Më 19 tetor, qeveria papritur e shfuqizoi vendimin e vitit 2010, duke krijuar një task forcë antikorrupsion në kuadër të policisë që e mbështeste punën e PSRK-së. Sipas Kryeministrit, vendimi origjinal ishte antikushetues, por as PSRK-ja dhe as Gjykata Kushtetuese nuk u këshilluan me sa duket për këtë çështje. Vendimi nuk ishte i koordinuar brenda koalicionit qeverisës, e as me bashkësinë ndërkombëtare. Ministri i Drejtësisë dhe misionet e ndryshme ndërkombëtare publikisht e kritikuan vendimin. Mediat komentuan se vendimi erdhi pas arrestimit të një kryetari të shquar të LDK-së (Rugovës). Mediat gjithashtu theksuan se disa prej hetimeve të profilit të lartë të task forcës përfshinin persona të shquar dhe të ekspozuar politikisht, përfshirë zyrtarë të ish-koalicionit qeverisës. Instituti i Kosovës për Drejtësi e cilësoi vendimin si hakmarrje politike, duke pasur parasysh hetimin e task forcës për zyrtarët e LDK-së. Instituti kritikoi më tej shkarkimin nga kryeministri Hoti të drejtorit të përgjithshëm të policisë, drejtorit të administratës tatimore dhe drejtorit të doganave, duke pohuar se këto shkarkime ishin bërë pa analiza të mjaftueshme ose transparencë dhe krijuan perceptimin se ishin bërë për t'i dëmtuar institucionet për zbatimin e ligjit.

Gjykimi i ish-ministrit të bujqësisë Nenad Rikallo dhe shtatë zyrtarëve të tjerë nga Ministria e Bujqësisë, të akuzuar në dhjetor 2019 për abuzim të pushtetit, vazhdoi në shtator. Grupi dyshohet se anashkaloi masat mbrojtëse ligjore dhe manipuloi me procesin e granteve të ministrisë për t'u dhënë miliona dollarë kompanive në pronësi të bashkëpunëtorëve politikë. Gjykata nuk mori asnjë vendim deri në nëntor.

Zbulimi financiar: Ligji i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e familjeve të tyre që ta deklarojnë pasurinë dhe prejardhjen e pasurisë së tyre në baza vjetore. Zyrtarët e lartë duhet t'i raportojnë edhe ndryshimet në pasuri kur e fillojnë apo ndërpresin shërbimin e tyre publik. AKK-ja i administron këto të dhëna, verifikon zbulimet dhe i publikon ato në ueb faqen e vet. Autoritetet mund t'i gjobisin zyrtarët e akuzuar për shkelje të vogla të kriterëve apo t'ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike deri në një vit. AKK-ja ua dërgon prokurorëve ankesat kundër zyrtarëve që nuk e deklarojnë pasurinë, të cilët më pas shqyrtojnë ngritjen e kallëzimeve penale.

### **Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut**

## KOSOVA

Një numër i madh i grupeve vendore e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi punoi pa u kufizuar nga qeveria, duke hetuar e publikuar gjetjet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria bashkëpunonte dhe nganjëherë u përgjigjeje pikëpamjeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Kushtetuta e përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit si institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, i mandatuar për t'i monitoruar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet e paligjshme ose të pahijshme, ose dështimet për të vepruar, nga autoritetet publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetencë për t'i hetuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar, dhe vepron si MKPT. Ky Institucion është agjencia kryesore përgjegjëse për monitorimin e qendrave të ndalimit. Në bazë të kompetencave të dhëna nga Kuvendi, Institucioni i Avokatit të Popullit mund të paraqesë raste *amicus curiae* në gjykatat themelore për të drejtat e njeriut. Ai gjithashtu mund të japë rekomandime mbi përshtatshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore ose administrative, udhëzimeve dhe praktikave.

### **Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave**

#### **GRATË**

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e kriminalizon dhunimin dhe dhunën në familje ndaj të gjithë personave, përfshirë dhunimin e një të afërmi/afërmeje ose të bashkëshortit/bashkëshortes. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg. EULEX-i theksoi se gjykatat shpesh shqiptonin dënime më të buta se dënimi më i ulët ligjor për rastet e dhunimit dhe se organet për zbatimin e ligjit rrallë ndërmerrnin masa për t'i mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët. Përveç kësaj, këto dënime shpesh uleshin nga gjykata e apelit. Zyra e Prokurorisë për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave raportoi për një numër të madh të rasteve të dhunës në familje gjatë vitit, prej 946 rasteve në vitin 2019 në 1.145 raste deri në tetor. Dhuna seksuale dhe dhunimi që ndodhnin brenda ose jashtë familjes ose njësisë shtëpiake rrallë raportoheshin nga viktimat, shpesh për shkak të stigmës shoqërore ose mungesës së besimit në autoritete.

Ligji e konsideron dhunën në baza gjinore si formë të diskriminimit, por i mungon një përkufizim i dhunës së bazuar në gjini për t'u përdorur në procedurat penale dhe civile. Organizatat për të drejtat e grave mbajtën një protestë në qershor për të tërhequr vëmendjen ndaj pabarazive midis të dyshuarve për dhunë në familje, të cilët janë përgjithësisht të burgosur, dhe të dyshuarve për sulme seksuale, të cilët shpesh lirohen. Grupet kërkuan që të dy llojet e krimeve të trajtohen në mënyrë të barabartë nga zyrtarët gjyqësorë.

Zyra e Prokurorisë për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave ndihmoi në sigurimin e qasjes në drejtësi për viktimat e të gjitha krimeve, me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikimin e personave, abuzimin e fëmijëve dhe dhunimin. Përveç kësaj, çdo zyrë e prokurorit

## KOSOVA

ka një prokuror që specializohet në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje. Këta prokurorë mund të përdorin mjete për vlerësim të rrezikut për ta shmangur rrezikun e ardhshëm të abuzimit të viktimës dhe atyre u është mundësuar të rekomandojnë dënime më të ashpra për recidivistët dhe shkelësit e urdhrave mbrojtës.

Policia i hetonte rastet e dhunës në familje përpara se t'i dërgonte ato te prokurorët të cilët vendosin për ngritjen e akuzave. Në gjysmën e parë të vitit, prokuroria procedoi me shpejtësi rastet e dhunës në familje dhe aktakuzat. Mirëpo, shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët dhe dënimet shpesh uleshin në apel. Avokatët dhe vëzhguesit e gjykatave pohuan se prokurorët dhe gjykatësit favorizuan bashkimin e familjes ndaj mbrojtjes së viktimave, me urdhra mbrojtës që ndonjëherë e lejonin kryesin të qëndronte në shtëpinë familjare gjersa rasti ishte në procedim. Dënimet sillleshin prej vërejtjeve gjyqësore deri në dënim me burg deri në pesë vjet. Kriminalizimi i dhunës në familje në prill 2019 u shoqërua me rritje të arrestimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për krim. Gjykata Themelore e Prishtinës mbajti seanca dëgjimore në internet për rastet e dhunës në familje në përputhje me masat qeveritare kundër pandemisë COVID-19.

Në shtator, një gjykatë themelore ia uli dënim me burgim të përjetshëm Pjeter Ndrecajt për vrasje në 24 vjet burg pasi Gjykata Supreme e ktheu çështjen në rigjykim. Ndrecaj u shpall fajtor për vrasjen e ish-gruas dhe vajzës së tij nëntë vjeçare në vitin 2018. Dënimi origjinal i gjykatës me 24 vjet ishte zgjatur në vitin 2019 nga Gjykata e Apelit, e cila gjeti rrethana rënduese që nuk ishin konsideruar nga gjykata themelore. Ish-gruaja e Ndrecajt kishte kërkuar ndihmë nga stacioni policor në Gjakovë disa orë para vrasjes, por policia nuk arriti ta gjente Ndrecajn para se të ndodhnin vrasjet. Si rrjedhojë, tre policë u suspenduan për pesë muaj për “abuzim të detyrës zyrtare”.

Qeveria licencoi dhe mbështeti 10 OJQ për t'u ndihmuar fëmijëve dhe grave të mbijetuara të dhunës në familje. Qeveria themeloi një linjë buxheti për mbështetje financiare të strehimoreve, duke zgjidhur kështu problemin afatgjatë të financimit. OJQ-të dhe strehimoret raportuan se i merrnin me kohë mjetet financiare.

Zyra e Kryeministrit themeloi një komision për njohjen dhe kompensimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës. Komisioni ka dhënë pensione për më shumë se 800 gra që nga viti 2018. PSRK-ja caktoi një prokuror për rastet e dhunës seksuale të kohës së luftës. Policia themeloi një njësi për rastet e krimeve të luftës, përfshirë rastet e dhunës seksuale të kohës së luftës.

Ngacmimi seksual: Ligji e përcakton ngacmimin seksual në procedurat civile dhe penale. Kodi penal përcakton dënimet me burg si dënim të shtuar për ngacmimin seksual kundër viktimave të cenuara dhe në rastet kur procedura penale fillon me kërkesën e viktimës. Në rastet kur një krim është kryer me përdorimin e një arme, dënimi mund të sillet prej një deri në pesë vjet burg. OJQ-ja Rrjeti i Grave të Kosovës raportoi se zbatimi i ligjeve për ngacmimin seksual u

## KOSOVA

pengua nga procedurat e përcaktuara dobët për parashtrimin e ankesave për ngacmim, dhe mungesa e qartësisë në lidhje me atë se cilat organe qeveritare duhet t'i marrin këto ankesa.

Sipas organizatave për të drejtat e gruas, ngacmimi seksual ishte i rëndomtë në vend të punës në sektorin publik e privat dhe në institucione të arsimit të lartë.

Detyrimi në kontrollin e popullsisë: Nuk pati raporte për abortim të detyruar apo sterilizim jovullnetar nga autoritetet qeveritare

Diskriminimi: Ligji parasheh status dhe të drejta të njëjta për gra dhe burra. Ligji kërkon rroga të njëjta për punën e njëjtë. Ligji përcakton që partnerët në martesë dhe bashkësi civile kanë të drejta të barabarta për të poseduar dhe trashëguar pronë, por meshkujt zakonisht e trashëgonin pronën e familjes dhe asetet e tjera. Në raste të rralla, të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni familjar i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa e veja të kthehej në familjen e saj amnore.

Relativisht pak gra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. Rrjeti i Grave të Kosovës raportoi që gratë shpesh u nënshtroheshin praktikave diskriminuese të punësimit.

Përzgjedhja e fëmijës bazuar në parapëlqimin gjinor: Raporti djem-vajza në lindje ishte 108 me 100. Qeveria nuk zbatoi politika për ta inkurajuar një ekuilibër më të barabartë gjinor.

## FËMIJËT

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo në bazë të lindjes në vend, përfshirë fëmijët e lindur nga prindërit shtetësia e të cilëve nuk dokumentohej. Ata që nuk ishin regjistruar kur ishin lindur ishin kryesisht nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. UNICEF-i tregoi se mungesa e regjistrimit mund të ndikojë negativisht në qasjen e fëmijës në ndihma sociale, posaçërisht për fëmijët e riatdhesuar. Fëmijët e paregjistruar konsiderohe sh in pa shtetësi.

Abuzimi i fëmijëve: Kodi Penal nuk e kriminalizon në mënyrë të posaçme abuzimin e fëmijëve, por trajton elemente të ndryshme të abuzimit të fëmijëve, përfshirë sulmin seksual, dhunimin, trafikimin dhe pornografinë e fëmijëve, ndër të tjera. Dënimet sillen prej pesë deri në 20 vjet burg. Nuk dihej shkalla e abuzimit të fëmijëve për shkak të stigmës shoqërore dhe mungesës së të dhënave të besueshme.

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve hyri në fuqi në korrik. OJQ-ja ndërkombëtare Terre des Homme Kosova i ndihmoi Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në hartimin e legjislacionit shtesë, si pjesë e masave gjithëpërfshirëse për zbatimin e ligjit. Ligji përcakton themelimin e

## KOSOVA

shtëpive që ofrojnë strehim të përkohshëm, mbrojtje dhe ndihmë emergjente për fëmijët viktime të abuzimit fizik apo seksual dhe i përcakton standardet për licencim dhe funksionim.

Në korrik 2019, një djalë nëntë vjeçar nga Fushë Kosove u dhunua dhe u vra. Nëna e djalit e kishte raportuar dhunimin e tij nga i dyshuari në polici para vrasjes, por i dyshuari u la i lirë pas marrjes në pyetje dhe nuk u arrestua më kurrë. Gjashtë muaj më vonë, fëmija u gjet i vdekur në Fushë Kosovë. I dyshuari më pas u arrestua për dhunim dhe vrasje të rëndë. Pas gjykimit, policia dhe prokurorët filluan t'i rishikojnë bashkërisht të gjitha procedurat dhe veprimet në rastet e abuzimit të fëmijëve. Hetimet disiplinore filluan kundër dy prokurorëve të përfshirë në këtë rast nën dyshimin se ata nuk arritën t'i adresojnë pretendimet për abuzim me kohë dhe në mënyrë efektive. Njëri nga prokurorët u ndëshkua nga Këshilli Prokurorial. Rastin e mori një avokat i të drejtave të njeriut dhe kërkoi që zyrtarët të mbaheshin përgjegjës për mosveprim.

Martesa e hershme dhe e detyruar: Ligji lejon që personat të martohen në moshën 16-vjeçare, me pëlqim të prindërve. Ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare për raste të martesës së hershme dhe të detyruar të fëmijëve, ajo ishte praktikë e rëndomtë në komunitetin rom, ashkali, egjiptian, boshnjak dhe goran. Sipas një raporti të qeverisë që përqendrohej në këto komunitete, rreth 12 për qind e fëmijëve, kryesisht vajza, martoheshin para moshës 15-vjeçare. Nivelet e larta të varfërisë në këto komunitete i kontribuuan kësaj përqindjeje.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personat që prodhojnë, përdorin apo përfshijnë fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë mund të dënohen prej një deri në 5 vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në 5 vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pëlqim është 16 vjeç. Dhunimi i të miturës është vepër penale dhe dënohet prej 5 deri në 20 vjet burg. Terre des Homme Kosova raportoi se mekanizmat kombëtar për identifikimin dhe referimin e fëmijëve që janë të cenueshëm nga shfrytëzimi seksual janë joefektivë. Organizata theksoi se fëmijët e transportuar nga Shqipëria për punë në rrugë identifikohen në mënyrë joadekuate si viktime të mundshme të trafikimit ose fëmijë në rrezik për trafikim. Komuna e Prishtinës themeloi një task forcë speciale që synonte adresimin e këtyre çështjeve dhe siguroi mbrojtje dhe shërbime të nevojshme për fëmijët e angazhuar në punën në rrugë.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Kosova nuk është palë e Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Shih *Raportin vjetor mbi rrëmbimin ndërkombëtar prindëror të fëmijëve* të Departamentit të Shtetit në: <https://travel.state.gov/content/travel/en/International-Parental-Child-Abduction/providers/legal-reports-and-data/report-d-cases>.

## ANTISEMITIZMI

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2020  
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë

## KOSOVA

Sipas komunitetit hebraik, në vend jetonin rreth 50 hebrej. Nuk pati raportime për akte antisemitike.

### TRAFIKIMI I PERSONAVE

Shih *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>.

### PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore, dhe sigurojnë qasje të barabartë në arsim, punësim dhe shërbime të tjera shtetërore. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara u përballën me diskriminim në qasje në arsim dhe punësim.

Në dhjetor, OJQ-ja Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës (Handi-Kos) paraqiti një vlerësim të legjislacionit të vendit për aftësinë e kufizuar, bazuar në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Raporti theksoi se shkollat fillore në Kosovë përgjithësisht nuk ofronin qasje adekuate për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe dizajni i brendshëm i objektit nuk siguronte statusin e barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara me moshatarët e tyre. Raporti theksoi se kjo mungesë e qasjes rezultoi në një shkallë më të lartë të braktisjes për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara thotë që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë do të prezantojnë legjislacion të veçantë që përcakton nivelin e aftësisë për punë për personat me aftësi të kufizuara. Mungesa e këtij legjislacioni ndikon drejtpërdrejt në punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe sforcon stigmën ekzistuese shoqërore rreth aftësisë së kufizuar.

Sipas Handi-Kos-it, shërbimet shëndetësore dhe rehabilituese, ndihma sociale dhe pajisjet ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara ishin të pamjaftueshme. Qasja fizike në institucionet publike mbeti e vështirë, edhe pas zbatimit të akteve nënligjore për qasje në ndërtesa dhe mbështetjes administrative. Handi-Kos raportoi se pajtimi i komunës me një urdhër të vitit 2007 për qasje në ndërtesat qeveritare është në shifra njëshe.

Vetë ndërtesa e parlamentit nuk ishte e qasshme dhe një anëtar i parlamentit me karrocë invalidësh duhej të transportohej në sallën e Kuvendit nga kolegët. Po kështu, në komunën e Suharekës, personat me karroca invalidësh kishin qasje vetëm në katin përdhes të ndërtesës së komunës, por jo në katet ku ishin zyrat e kryetarit dhe të drejtorëve. Mundësitë arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara ishin të kufizuara. Sipas Handi-Kos-it, rreth 38.000 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk e vijuan shkollën.

## KOSOVA

Në gusht, Institucioni i Avokatit të Popullit publikoi një raport në të cilin e kritikonte qasjen e pabarabartë në transportin ndërurban për personat e verbër, pavarësisht kërkesave ligjore për një qasje të tillë. Ai rekomandoi uljen e tarifave të transportit për personat me aftësi të kufizuara, rezervimin e dy ulëseve në transportin publik për udhëtarët me aftësi të kufizuara dhe autorizimin e një numri minimal të inspektimeve për zbatim të ligjit në muaj për automjetet e transportit publik urban dhe ndërurban. Deri më sot, asnjë entitet ose organizatë nuk i është përgjigjur këtij raporti.

Ligji rregullon vendosjen e personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose shoqëror dhe i mbron të drejtat e tyre brenda institucioneve të tilla, por nuk është zbatuar. Vendit i mungon një sistem adekuat për klasifikimin e procedurave, vendosjen dhe trajtimin e të paraburgosurve me aftësi të kufizuara mendore. QKRMT-ja theksoi se objektet e shëndetit mendor ishin nën standarde dhe përgjithësisht ishin me kapacitet të plotë. QKRMT-ja gjithashtu theksoi nevojën për kapacitet shtesë, posaçërisht për gratë dhe të miturit me aftësi të kufizuara mendore. Instituti i Psikiatrisë Mjekoligjore kishte një kapacitet prej 36 shtretërisht, nga të cilët 12 ishin për ekzaminime psikiatrike dhe 24 ishin për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Instituti nuk kishte një vend specifik për trajtimin e grave dhe të miturve. Ka pasur raste kur autorët e dhunës në familje me aftësi të kufizuara mendore nuk e kanë përfunduar kujdesin e detyrueshëm psikiatrik, por janë larguar nga objektet e institucionit për shkak të infrastrukturës dhe kapacitetit joadekuat.

QKRMT-ja theksoi se mungesa e kapacitetit në Institutin e Psikiatrisë Mjekoligjore bëri që të paraburgosurit me aftësi të kufizuara mendore të dërgoheshin në qendrat standarde korrektuese në vend se në institucionet e shëndetit mendor, në kundërshtim me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare.

### **ANËTARËT E GRUPEVE TË PAKICAVE KOMBËTARE/RACIALE/ETNIKE**

Dhuna shoqërore kundër serbëve dhe komuniteteve të tjera pakicë vazhdoi, të gjitha ishin të prekura nga diskriminimi shoqëror dhe diskriminimi në punësim.

Komuniteti serb, përfaqësuesit e tij, shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar shprehën shqetësim lidhur me incidentet ku përfshiheshin vjedhjet, plaçkitjet, ngacmimet verbale dhe dëmtimet e pronës së serbëve të Kosovës, veçanërisht të të kthyerve në zonat rurale. OJQ-ja AKTIV raportoi për shumë se 20 incidente ndërmjet marsit dhe qershorit që synonin serbët e Kosovës, përfshirë zjarrvëniet, sulmet fizike dhe grabitjet. Midis janarit dhe tetorit, Ministria për Komunitete dhe Kthime pranoi ankesa për 49 incidente të sigurisë që prekën serbët e Kosovës dhe të kthyerit. Për shembull, ministria lëshoi një komunikatë për shtyp më 28 prill me të cilën e dënonte djegien e një shtëpie në Cernicë dhe më 27 maj lëshoi një komunikatë për shtyp me të cilën e dënonte gjuajtjen me gurë të një shtëpie të të kthyerit në Lubozhdë dhe një sulm fizik në Drenovc. Ministria i bëri thirrje publike policisë për t'i shtuar patrullimet në vendet kritike dhe për t'i sjellë autorët e krimeve para drejtësisë.

## KOSOVA

Përfaqësuesit serbë të Kosovës pretenduan se urrejtja etnike ishte motivi kryesor për disa incidente, si gjuajtja me gurë e shtëpive të të kthyerve, rastet e zjarrvënies dhe mbishkrimet me grafit. Përfaqësuesit pohuan që qeveria nuk u përgjigjej në mënyrë adekuate këtyre incidenteve. Në disa raste, hetimet e policisë rezultuan në arrestimin e autorëve.

Në tetor, thuhet se persona të panjohur qëlluan mbi një grup të rinjsh serbë të Kosovës në shkollën e fshatit Bërnice e Poshtme në komunën e Prishtinës. Askush nuk u lëndua në këtë incident. Sipas raporteve të mediae dhe të rinjve, autorët e krimit flisnin shqip. Policia u pajtua ta shtojë praninë e policisë në këtë zonë pas një takimi të mbajtur më 4 tetor midis serbëve të Kosovës, përfaqësuesve të tyre, policisë dhe KFOR-it. Policia arrestoi një person në lidhje me këtë incident.

Ngacmimi i anëtarëve serbë të Kosovës në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) nga serbët e tjerë etnikë ishte i rëndomtë, ndonëse zakonisht ishte vështirë të gjurmoheshin incidentet e tilla. Në shumicën e rasteve, viktimat nuk i raportuan incidentet në polici nga frika e përshkallëzimit dhe hakmarrjes. Në qershor, një gjykatë lokale urdhëroi ndalimin 30-ditor të një serbi të Kosovës për ngacmimin e një pjesëtari serb të FSK-së në mediat sociale. Sipas prokurorisë, viktima mori porosi kërcënuese pasi i dyshuari postoi një foto të viktimës me uniformë bashkë me Ramush Haradinajn, një ish-kryeministër e komandant i UÇK-së. I dyshuari e hoqi postimin, por viktima vazhdoi të merrte porosi kërcënuese. Pjesëtarët serbë të FSK-së gjithashtu ndaloheshin në mënyrë rutinore nga autoritetet serbe në pikat kufitare Kosovë-Serbi.

Ministria e Mbrojtjes dhe udhëheqja e FSK-së ndërmorën disa hapa për t'i mbrojtur pjesëtarët serbë të Kosovës. Këta hapa përfshinin dokumentim më të mirë të incidenteve, kontrolle rutinore të mirëqenies nga komandantët dhe përpjekje për ta përmirësuar reagimin e policisë dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Qeveria filloi një fushatë rekrutimi për FSK-në ku udhëheqësit i shumëfishuan përpjekjet për rekrutimin e pakicave.

Qasja në drejtësi për serbët e Kosovës ishte përmirësuar në sajë të integritimit në vitin 2017 të sistemit gjyqësor në katër komunat veriore me shumicë serbe dhe integritit të gjyqtarëve dhe stafit serb të Kosovës në gjykatat e tjera themelore në vend. Gjyqësori vuante nga mungesa e financimit dhe mbështetjes përkatëse. Përkthimi i dobët ose i vonuar në procedura gjyqësore, numri i madh i lëndëve të grumbulluara në veri, mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave, numri i kufizuar i stafit të pakicave, dhe mospërputhja midis përkthimeve të legjislacionit në gjuhën shqipe dhe serbe vazhduan ta pengonin ofrimin e duhur të drejtësisë për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera pakicë.

Komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian shpesh i mungonte qasja në higjienën themelore, kujdesin mjekësor dhe shkollim, dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë. Qeveria u siguroi ndihma në ushqim dhe higjienë këtyre komuniteteve që nga marsi për shkak të kufizimeve të lëvizjes që lidhen me COVID-19. Përfaqësues të komunitetit dhe shoqëria civile theksuan se ndihma nuk ishte e mjaftueshme për t'i mbrojtur anëtarët e këtyre

## KOSOVA

komuniteteve nga ekspozimi ndaj virusit dhe nga përhapja e virusit përmes punës që tradicionalisht e bënin në rrugë.

Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve dhe Institucioni i Avokatit të Popullit theksuan diskriminimin në punësim në sektorin publik pothuaj në të gjitha institucionet lokale dhe nacionale. Ndonëse ligji obligon që 10 për qind e nëpunësve në nivelin lokal dhe nacional të qeverisë të jenë anëtarë të pakicave, përfaqësimi i tyre mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi ishte i kufizuar në pozita të nivelit të ulët. Komunitetet më të vogla, si goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, ishin të nën-përfaqësuar.

Ligji kërkon kushte të barabarta për të gjithë nxënësit dhe njeh të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave deri në mbarim të shkollës së mesme. Ky ligj nuk u zbatua. Udhëheqësit e komunitetit boshnjak, kroat, goran, malazez, rom dhe turk theksuan mungesën e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera në gjuhën serbe, boshnjake e turke, herë pas here përdornin kurrikulën në gjuhën shqipe ose kurrikulën e sponsorizuar nga Serbia ose Turqia për t'i mësuar nxënësit.

Zyra e Komisionerit për gjuhët monitoronte dhe raportonte për zbatimin e legjislacionit që u jepte status të barabartë dy gjuhëve zyrtare të vendit, shqipes dhe serbishtes, si dhe gjuhëve zyrtare në nivel lokal, përfshirë gjuhën boshnjake dhe turke. Komisioneri raportoi se administratat komunale dhe institucionet e qeverisë qendrore nuk ishin konsistente në zbatimin e dispozitave të ligjeve kombëtare për gjuhët, për shembull, në sigurimin e përkthimeve në gjuhën serbe të deklaratave të qeverisë, përfshirë njoftimet emergjente, gjatë pandemisë COVID-19, një ankesë e përsëritur nga grupet e shoqërisë civile të serbëve të Kosovës. Zyra e Komisionerit për gjuhët gjithashtu raportoi se moszbatimi i vazhdueshëm i ligjeve për gjuhët nënkuptonte që shumë qytetarëve u ishte mohuar qasja e barabartë në shërbime publike, informim, punësim, drejtësi dhe të drejta të tjera.

Mungesa e përkthimit ose përkthimi i dobët gjithashtu u raportua si problem që ka të bëjë me ligjet e shumta, shenjat brenda institucioneve publike dhe komunikimin gjatë procedurave gjyqësore. Për të adresuar problemin e legjislacionit të përkthyer në mënyrë jokonsistente, qeveria miratoi një koncept dokument të sponsorizuar nga Komisioneri për gjuhët në maj 2019 me të cilin që kërkonte krijimin e një njësie qeveritare për përkthime. Kjo njësi nuk ishte krijuar deri në nëntor.

Gjykatat rregullisht dështuan të ofronin shërbime adekuate të përkthimit dhe interpretimit për të pandehur dhe dëshmitarë të pakicave dhe nuk ofronin përkthim adekuat të statutit dhe dokumenteve gjyqësore siç kërkohet me ligj. OJQ-ja serbe e Kosovës AKTIV raportoi se gjykatat ua dërgonin vendimet e tyre, përfshirë vendimet për paraburgim dhe aktgjykimet, në gjuhën shqipe anëtarëve të komunitetit serb të Kosovës dhe të pakicave të tjera. AKTIV-i theksoi se praktikrat e tilla e pengojnë qasjen në mjetet juridike për anëtarët e komuniteteve pakicë.

## KOSOVA

Ndryshimet e bëra në vendime administrative u lejojnë boshnjakëve dhe turqve të kenë dokumente identiteti të lëshuara në gjuhën e tyre, por përfaqësues të pakicave shpesh ankoheshin për trajtim të dobët nga nëpunësit publikë dhe zbatim të vonuar.

### **AKTET E DHUNËS, DISKRIMINIMI DHE ABUZIMET E TJERA TË BAZUARA NË ORIENTIM SEKSUAL DHE IDENTITET GJINOR**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor në punësim, kujdes shëndetësor dhe shkollim. Kur motivi për krim është i bazuar në gjini, orientim seksual apo lidhje të perceptuar të viktimës me personat që janë objekt i armiqësisë së tillë, ligji e konsideron atë motiv si rrethanë rënduese.

Sipas OJQ-ve për të drejtat e njeriut, komuniteti i lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjnorëve dhe interseksualëve (LHBTI) përballej me diskriminim të hapur në punësim, strehim, përcaktim të shtetësisë dhe qasje në shkollim e kujdes shëndetësor.

OJQ-ja Qendra për Barazi dhe Liri raportoi se presioni shoqëror i bindi shumicën e personave LHBTI ta fshehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. Një përfaqësues theksoi që policia nuk ishte e ndjeshme ndaj nevojave të komunitetit LHBTI. Qendra gjithashtu i ceku reagimet publike homofobike në rritje në mediat sociale që nga fillimi i zbatimit të masave të qeverisë në tërë vendin kundër pandemisë COVID-19.

Policia ishte përfshirëse dhe pranonte LHBTI-të dhe komunitetet e tjera të pakicave në porositë e tyre publike, dhe zyrtarë të lartë të policisë morën pjesë në paradën vjetore të krenarisë. Komuna e Prishtinës krijoi një qendër ditore për personat LHBTI në rrezik.

Në gusht 2019, Gjykata e Apelit miratoi një aktvendim të Gjykatës Themelore që lejonte ndërrimin e gjinisë në dokumente të identifikimit nga gjinia femërore në atë mashkullore për një qytetar që jeton jashtë vendit. Gjithsej dy qytetarë i ndërruan dokumentet e tyre të identifikimit pas procedurave të gjata gjyqësore, ndërsa kërkesat e katër qytetarëve për ndërrimin e dokumenteve të identifikimit nuk janë zgjidhur.

Më 4 shtator, Kryeministri Hoti dhe Presidenti serb Vuçiq nënshkruan marrëveshje me të cilat të dy vendet u pajtuan të punojnë me qeveritë e huaja për ta dekriminalizuar homoseksualitetin në 69 vendet ku ai konsiderohet krim.

### **STIGMA SHOQËRORE PËR HIV DHE AIDS**

Nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar ndaj personave me HIV/AIDS gjatë vitit.

### **Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve**

## KOSOVA

### **A. LIRIA E ASOCIIMIT DHE E DREJTA PËR TË NEGOCIUAR KOLEKTIVISHT**

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave të pavarura, për të negociuar kolektivisht dhe për të bërë greva. Ligji ndalon diskriminimin antisindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij/saj sindikale. Ligji kërkon rikthimin e punëtorëve të larguar nga puna për shkak të veprimtarisë sindikale, përfshirë në shërbimet themelore. Ligji zbatohet njëloj për të gjithë individët që punojnë në sektorin publik dhe privat, përfshirë migrantët e dokumentuar dhe punëtorët vendorë.

Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efektive ligjet e punës, të cilët përfshinin rregullore dhe udhëzime administrative që i rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, përfshirë të drejtën e lirisë së asociimit dhe negociimit kolektiv. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), burimet, inspektimet dhe masat mbrojtëse nuk ishin adekuate dhe gjambat nuk ishin në përputhje me gjambat për shkelje të ngjashme. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin të ngatërruara dhe u nënshtroheshin vonesave të gjata apo ankesave.

Punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht, posaçërisht në sektorin privat. BSPK-ja raportoi se shumë punëdhënës të sektorit privat në përgjithësi i shpërfillën ligjet e punës.

BSPK-ja raportoi për vështirësi të vazhdueshme në formimin e sindikatave për shkak të ndërhyrjes së punëdhënësve në shoqatat dhe sindikatat e punëtorëve, posaçërisht në sektorin bankar, të ndërtimitarisë dhe atë hotelier. Përfaqësues të këtyre sektorëve i thanë BSPK-së në kushte anonimiteti se disa punëdhënës përdorën kërcënimin për ta penguar formimin e sindikatave. Inspektorati i Punës raportoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë zyrtare për diskriminim ndaj punëtorëve që u përpoqën t'u bashkohen sindikatave gjatë vitit. Megjithatë, Inspektorati nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe të stafit. Përveç kësaj, punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave dhe sindikatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht ose për t'u lidhur me sindikatat jashtë organizatës së tyre, posaçërisht në sektorin privat.

### **B. NDALIMI I PUNËS SË DHUNSHME APO TË DETYRUAR**

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive ligjin dhe puna e dhunshme, përfshirë punën e detyruar të fëmijëve, ndodhi (shih Seksionin 7.c.) gjatë vitit. Burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, nuk mjaftonin për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Inspektorati i punës raportoi se kishte kryer vetëm hetime të kufizuara për vepra të punës së dhunshme. Dënimet, ndonëse ishin në përputhje me dënimet për krime të tjera të rënda, rrallë zbatoheshin.

Shih gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>.

### C. NDALIMI I PUNËS SË FËMIJËS DHE MOSHA MINIMALE PËR PUNË

Ligji i ndalon të gjitha format e këqija të punës së fëmijës. Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet.

Ligji i vitit 2020 për mbrojtjen e fëmijëve i përcakton standardet kryesore të mbrojtjes së punës së fëmijëve që i bashkon të gjitha dokumentet e tjera ligjore dhe nënligjore për këtë temë. Ai parashikon dënime shtesë për punëdhënësit formalë dhe joformalë të fëmijëve që janë në përputhje me dënimet për krime të ngjashme. Ligji nuk e trajton plotësisht problemin e punës së fëmijëve, pasi ligji ka pak ndikim në ekonominë joformale

Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. Dënimet zbatoheshin rrallë. Inspektorët menjëherë i njoftonin punëdhënësit kur të miturit shfrytëzoheshin ose gjendeshin të përfshirë në kushte të rrezikshme të punës. Puna e fëmijëve ndodhi kryesisht në sektorin joformal. Që nga maji, OJQ-ja Terres Des Hommes raportoi rastet e 116 të miturve (105 shtetas të Kosovës dhe 11 të mitur nga Shqipëria) që punonin në kushte të rrezikshme. Prej tyre, 73 ishin fëmijë të angazhuar në lypje, 13 në punë në rrugë dhe 14 në nxjerrjen e thëngjillit.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve raportoi se fëmijët që punonin në bujqësi hasnin në rreziqe që lidheshin me përdorimin e pajisjeve bujqësore. Koalicioni raportoi se puna e fëmijës në bujqësi vazhdoi si aktivitet tradicional. Qendrat për punë sociale, të drejtuara nga qeveria, raportuan se fëmijët e angazhuar në aktivitete bujqësore ishin kryesisht në sektorin joformal dhe nuk pengoheshin nga vijimi i mësimin. Ndonëse fëmijët rrallëherë ishin siguresit kryesorë të të ardhurave për familjet e tyre, puna e fëmijës kontribuonte shumë në të ardhurat e disa familjeve.

Fëmijët në zonat urbane shpesh punonin në një sërë punësh joformale në ndërtimtari dhe të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve, ushqimit ose kartelave të telefonit në rrugë. Disa fëmijë, posaçërisht fëmijët nga pakicat etnike ose nga familjet që marrin ndihmë sociale, gjithashtu angazhoheshin në punë fizike, si transportimi i mallrave dhe mbledhja e sendeve në grumbuj të mbeturinave për t'i shitur.

Shih *Konkluzionet mbi format më të këqija të punës së fëmijës* të Departamentit të Punës në: <https://www.dol.gov/agencies/ilab/resources/reports/child-labor/findings/>.

### D. DISKRIMINIMI NË LIDHJE ME PUNËSIMIN DHE PROFESIONIN

Ligji ndalon diskriminimin lidhur me punësimin në bazë të racës, fesë, origjinës kombëtare, seksit, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit HIV ose AIDS ose përkatësisë politike. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive ligjin

## KOSOVA

dhe dënimet nuk ishin në përputhje me dënimet për krime të ngjashme. Diskriminimi në punësim dhe profesion ndodhi në të gjithë sektorët në bazë të seksit, gjinisë, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, fesë, përkatësisë politike dhe statusit të pakicës (shih Seksionin 6). Gjatë vitit, BSPK-ja pranoi raporte nga sindikatat e punës dhe individët që pohonin për diskriminim në bazë të anëtarësimit sindikal, moshës dhe gjendjes familjare. Zyrtarë të BSPK-së dhe të sindikatave theksuan se punësimi, posaçërisht në sektorin publik, shpesh varej nga statusi dhe përkatësia politike e punëtorit. Zyrtarë të sindikatës raportuan për keqtrajtime të tjera, përfshirë ngacmimin seksual, të bazuara në përkatësinë politike partiake. BSPK-ja raportoi raste kur punëdhënësit i diskriminuan femrat gjatë intervistave për punësim dhe i përjashtonin në mënyrë të paligjshme për shkak të shtatzënisë ose për shkak se kërkonin pushim të lehonisë.

Zyrtarët e Universitetit të Prishtinës theksuan mungesën e hapësirës për lutje në mjediset e universitetit. Qendra e Kosovës për Paqe raportoi për disa raste të studenteve në Fushë Kosovë dhe Gjakovë të cilave u ishte ndaluar hyrja në shkollën fillore për shkak të veshjes së rrobave fetare.

### **E. KUSHTET E PRANUESHME TË PUNËS**

Rroga minimale, e caktuar nga qeveria, ishte më e lartë se pragu zyrtar i varfërisë.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagesën shtesë për punën jashtë orarit dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe 12 muaj pushim pjesërisht të paguar të lehonisë. Ligji i punës i përcakton standardet e shëndetit dhe të sigurisë për vende të punës dhe qeveris me të gjitha industritë në vend. Përgjegjësia për identifikimin e vendeve të pasigurta të punës u takon ekspertëve të sigurisë dhe shëndetit në punë, e jo punëtorëve.

Inspektorët e punës ishin përgjegjës për zbatimin e të gjitha standardeve të punës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me rrogat, orarin e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive ligjin dhe gjobat nuk ishin në përputhje me gjobat për shkelje të ngjashme. Numri i inspektorëve ishte i pamjaftueshëm për t'i parandaluar shkeljet në sektorin formal dhe joformal dhe zbatimi u kufizua edhe më shumë nga pandemia COVID-19. Inspektorët kanë të drejtë të bëjnë inspektime të paparalajmëruara dhe të fillojnë sanksione.

BSPK-ja raportoi për mungesën e zbatimit të ligjit nga gjyqësori, posaçërisht në sektorin joformal, duke i cituar kufizimet në burime dhe kapacitete brenda Inspektoratit të Punës.

Sipas BSPK-së, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës të cilat siguronin standarde të barabarta të mbrojtjes për punëtorët e sektorit publik dhe privat. BSPK-ja raportoi për mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit të ligjit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Shumë

## KOSOVA

individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, gjoja “sipas dëshirës së tyre”, pa kontratë pune, pagesë të rregullt apo kontribute pensionale. BSPK-ja raportoi se punëdhënësit i përjashtonin punëtorët pa arsye në kundërshtim me ligjin dhe refuzonin t'i respektonin festat e punëtorëve. Organizatat për të drejtat e gruas raportuan se abuzimi dhe ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte pa u raportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo hakmarrja.

Ligji nuk u lejon punëtorëve të largohen nga një situatë e rrezikshme e punës pa e rrezikuar punësimin e tyre. Sipas Ministrisë së Punës, marrëveshjet joformale punëdhënës-punonjës mund të adresojnë kur dhe nëse punëtorët mund të largohen nga puna për shkak të situatave të rrezikshme të punës, por qeveria nuk i ndoqi këto marrëveshje. Gjatë vitit pati tetë vdekje të punëtorëve si rezultat i kushteve të papërshtatshme ose të pasigurta të punës. Sipas ekspertëve, shkeljet e standardit të rrogës, të punës jashtë orarit, të shëndetit dhe sigurisë në punë ishin njëloj për burra dhe për gra, si dhe për punëtorët e huaj migrantë, posaçërisht për ata që ballafaqoheshin me kushte të rrezikshme apo eksploatuese të punës, si në ndërtimtari dhe bujqësi.